

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Kosovë

Raport vjetor 2022

1 janar - 31 dhjetor 2022

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut – Sekretariati

Rr. Rustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +383 (0) 38 78 4178

Posta elektronike: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Parathënie

Ky është raporti vjetor i trembëdhjetë i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (këtu e tutje, "Paneli" ose "PShDNj") që mbulon periudhën nga 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2023.

Ky raport është përgatitur nga Paneli dhe i prezantohet Misionit, shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese, si dhe publikut të gjerë me qëllim të shpërndarjes së informacionit mbi zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe aktiviteteve të Panelit.

Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka mbajtur dy (2) seanca dhe ka miratuar gjithsej pesë (5) vendime në katër (4) lëndë. Po ashtu, në një (1) lëndë, kryesuesi i ka paraqitur kërkesë shefit të Misionit për zbatimin e masave të përkohshme.

Gjatë vitit 2022, masat e shëndetit publik në fuqi për të luftuar pandeminë COVID-19 u lehtësuan mjaftueshëm, saqë Paneli ishte në gjendje të kryente punën e tij nga zyra në Kosovë. Të dyja seancat e Panelit janë mbajtur në Prishtinë.

Paneli vazhdoi të vuante nga ndryshimet në përbërjen e tij gjatë vitit 2022. Vendi i lirë i hapur në vitin 2021 për një anëtar të jashtëm të Panelit nuk u plotësua gjatë vitit 2022 për shkak të sfidave me rekrutim si pasojë e politikave të drejtorit menaxhues (CivOpsCdr) të Kapacitetit të Planifikimit Civil dhe Sjelljes (CPCC) të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian (EEAS). Si pasojë, znj. Snježana Bokulić mbeti kryesuese në cilësinë "ushtruese e detyrës".

Në gusht 2022, anëtari i Panelit nga EULEX-i, z. Alexander Fassihi, dha dorëheqjen dhe nuk ishte e mundur të zgjidhej një zëvendësues gjatë vitit 2022. Paneli dëshiron të shfrytëzojë rastin për të falënderuar z. Fassihi për kontributin e tij të çmuar në punën e Panelit.

Në vitin 2022 nuk është regjistruar asnjë ankesë e re. Paneli përfundoi dy (2) lëndë, duke e shpallur një lëndë të papranueshme dhe duke konstatuar në një rast tjetër se përcjellja e mëtutjeshme nuk do të ishte efektive.

Deri më 31 dhjetor 2022, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e tre (23) lëndë. Nga këto, njëzet e një (21) raste ku ishte konstatuar shkelje e të drejtave të ankuesit mbeten të hapura dhe i nënshtrohen vlerësimit të Panelit për zbatimin e rekomandimeve të tij nga shefi i Misionit.

Nga njëzet e tre (23) rastet e pazgjidhura, njëzet (20) kanë të bëjnë me rastet e zhdukjeve të dhunshme gjatë dhe pas konfliktit të Kosovës 1998-1999. Të gjitha këto raste fillimisht i janë komunikuar shefit të Misionit të EULEX-it në dhjetor të vitit 2017. Asnjë progres nuk është bërë në këto raste gjatë vitit 2018, kryesisht për shkak të rikonfigurimit të Misionit. Gjatë viteve 2019, 2020, 2021 dhe 2022, Paneli ka mundur të marrë vendime për pranueshmërinë dhe meritat në secilën prej këtyre rasteve.

Pavarësisht konstatimit të parë të Panelit për shkelje në vitin 2019 të të drejtave të ankuesit për një hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të familjes së tyre, dhe konstatimeve të vazhdueshme të shkeljeve identike në të gjitha rastet e tjera të zhdukjes me forcë, Misioni nuk ka bërë ndonjë përparim në zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Paneli mbetet i zhgënjyer dhe i shqetësuar që rekomandimet e tij ende nuk janë zbatuar plotësisht nga Misioni.

Në vitin 2021, shefi i Misionit e informoi Panelin se synonte të zhvillonte takime personale me secilën nga familjet e prekura. Deri më sot janë mbajtur vetëm katër (4) takime të tilla. Përderisa kufizimet për shkak të pandemisë Covid-19 si dhe tensionet politike në veri të Kosovës kanë luajtur rol në vonesë, këto çështje nuk duhet të përdoren si arsye për mos zbatimin nga ana e Misionit e rekomandimeve të Panelit.

Shqetësime të ngjashme lidhen me moszbatimin e rekomandimeve nga ana e Misionit në rastin e familjeve rome që kishin kaluar shumë vite në kampet për persona të zhvendosur në tokë të kontaminuar me plumb. Në vitin 2015, Paneli konstatoi se Misioni kishte dështuar t'u ofronte këtyre familjeve mjete juridike efektive për shkeljen e të drejtave të tyre themelore. Që nga ajo kohë, Paneli ka konstatuar në katër (4) raste të veçanta se Misioni ka dështuar në zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Në vitin 2022, Misioni nuk iu përgjigj ftesës së pestë të Panelit për të raportuar mbi zbatimin e rekomandimeve të Panelit.

Paneli është i zhgënjyer dhe i shqetësuar që këto raste ilustrojnë mungesën e angazhimit nga ana e Misionit me rekomandimet e Panelit. Të gjitha këto raste zbulojnë shkelje të rënda nga ana e Misionit të të drejtave themelore të ankuesve. Rekomandimet e Panelit synojnë të korrigjojnë këto shkelje, të paktën deri në një farë mase. Misioni duhet të sigurojë që viktimave të shkeljeve të tij t'u ofrohen mjete efektive, si për hir të viktimave ashtu edhe për hir të reputacionit të Misionit.

Snježana Bokulić
Kryesuese e Panelit
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
5 korrik 2023

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	1
Parathënie.....	2
1. Korniza rregullative.....	5
1.1. Veprimi i Këshillit CFSP 2018/856 i datës 8 qershor 2018.....	5
1.2. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë.....	5
1.3. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009.....	5
1.4. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.....	6
1.5. Rregullorja e punës.....	6
2. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave.....	7
2.1. Numri i lëndëve dhe statistikat.....	7
2.2. Subjekti i ankesave.....	8
2.3. Seancat e Panelit.....	8
3. Jurisprudenca.....	9
3.1. Hyrje.....	9
3.2. Vendimet për meritat.....	9
3.3. Vendimet e pranueshmërisë.....	9
3.4. Vendimet rreth kërkesave për rishqyrtim.....	10
3.6. Vendimet pasuese.....	10
4. Aktivitetet e tjera të Panelit.....	11
4.1. Takimet.....	11
4.2. Fushata informuese.....	11
4.2.1. Takimet me organizatat kosovare.....	11
4.3. Trajnimi hyrës.....	11
4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së.....	12
5. Paneli dhe Sekretariati.....	12
5.1. Anëtarët e Panelit.....	12
5.1.1. Kryesuesja e Panelit.....	13
5.1.2. Anëtarët deri më 31 dhjetor 2022.....	13
5.2. Sekretariati.....	14
6. Çështjet operative dhe administrative.....	14
6.1. Buxheti.....	14
6.2. Burimet njerëzore.....	14
7. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	14
7.1. Konsideratat e përgjithshme.....	14
7.3. Programi i reparacionit.....	15
7.4. Rastet e personave të zhdukur.....	15

7.5	Misioni dhe të drejtat e njeriut.....	16
SHTOJCA 1	Statistikat 2010 – 2022	17
SHTOJCA 2	TABELA E SHKELJEVE DHE VENDIMET PASUESE – 31 dhjetor 2022	18
SHTOJCA 3	Vendimet e Panelit 2010-2022	19

1. Korniza rregullative

Baza ligjore për funksionimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë (këtu e tutje, “Misioni”), rrjedh përgjithësisht nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244(1999) e datës 10 qershor 1999 dhe sigurohet në mënyrë specifike me vendime të Këshillit Evropian të Bashkimit Evropian. Këto vendime të Këshillit shërbejnë për të zbatuar Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM) të Bashkimit Evropian.

1.1. Veprimi i Këshillit CFSP 2018/856 i datës 8 qershor 2018

Në mandatin e tij aktual, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit CFSP 2018/856, EULEX-i Kosovë monitoron lëndët dhe seancat gjyqësore të përzgjedhura në institucionet penale dhe civile të Kosovës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në lëndët që i janë dorëzuar institucioneve kompetente të Kosovës. Për më tepër, EULEX-i Kosovë mban një numër të kufizuar të kompetencave ekzekutive, ndër të tjera, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, inteligjencën kriminale dhe ruajtjen e rendit publik, si reagues i dytë nga autoritetet vendore.

1.2. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë

Veprimi i përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencave të Misionit EULEX-i Kosovë. Në atë veprim përcaktohet *mandati* i EULEX-it Kosovë dhe, ndër të tjera, specifikohet përgjegjësia e tij për të vepruar në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut, neni 3 (i): “*të sigurojë që të gjitha aktivitetet e tij t’i respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe përfshirjen gjinore*”.

1.3. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Themelimi i një mekanizmi të pavarur, efektiv dhe transparent për llogaridhënie në lidhje me të drejtat e njeriut ishte konsideruar të jetë kriter themelor për EULEX-in Kosovë si mision për sundim të ligjit me disa funksione ekzekutive të kufizuara. Këto funksione ekzekutive përfshinin funksione të ndryshme në polici dhe prokurori, të rezervuara për zyrtarët e EULEX-it në lidhje me ruajtjen e rendit publik, hetimin penal dhe ndjekjen penale, veçanërisht për krime të luftës dhe krim të organizuar, dhe ndihmës në antropologjinë e mjekësisë ligjore. Një mekanizëm i jashtëm i tillë i llogaridhënies kishte për qëllim ta plotësonte llogaridhënien e përgjithshme të Misionit EULEX-i Kosovë, siç parashihet me Skemën e Sigurimit të Përgjegjësisë për Palën e Tretë dhe Mekanizmin e Brendshëm Disiplinor të EULEX-it.

Andaj, Koncepti i llogaridhënies përcaktoi *mandatin* e Panelit që: *të shqyrtojë ankesa nga çdo person, që nuk është pjesë e personelit të EULEX-it Kosovë që pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë.*¹

Megjithatë, sipas Konceptit të llogaridhënies, Paneli nuk ka juridiksion në lidhje në gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it janë anëtarë të trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

Paneli ka miratuar rregulloren e punës më 10 qershor 2010, ku pas kësaj date Paneli është autorizuar të pranojë ankesa. Paneli i ka ndryshuar rregullat e veta më 21 nëntor 2011 dhe 15 janar 2013, 15 janar 2019 dhe prapë më 11 dhjetor 2019.

1.4. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Në pajtim me dispozitat e Konceptit të llogaridhënies, Paneli mund të shqyrtojë ankesa në lidhje me pretendimet e shkeljeve, në mes të tjerash, të instrumenteve të të drejtave të njeriut si në vijim:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MDCP, 1966)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (MDESK, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave (KEFDF, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimin apo Dënimit tjetër Mizer, Çnjerëzor apo Poshtëruar (KKT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (KDF, 1989)

Në praktikë, ankesat që janë paraqitur deri më sot kryesisht janë bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj. Një numër i ankesave po ashtu i janë referuar Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut. Janë bërë referenca gjithashtu në një numër rastesh për praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut, Konventat e Gjenevës dhe Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

1.5. Rregullorja e punës

Si pasojë e hyrjes në fuqi më 15 qershor 2018 të Vendimit të Këshillit CFSP 2018/856, mandati dhe përbërja e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut u ndryshua gjithashtu. Për të pasqyruar këto ndryshime, Rregullorja e punës duhej të ndryshohej.

Më 15 Janar 2019, Paneli miratoi Rregulloren e Procedurës së Punës të rishikuar për ta harmonizuar me ndryshimin e mandatit të Misionit dhe nevojën për të ri kompozuar Panelin.

Më 11 dhjetor 2019, Paneli miratoi një amendament në rregullin 43 të rregullores së punës, për të lejuar që të dy palët në një ankesë të jenë në gjendje të paraqesin kërkesë për rishikimin e gjetjeve të një vendimi të Panelit, në rrethana kur informacioni i ri kishte dalë në dritë, e që nuk ishte në dispozicion në kohën kur Paneli kishte marrë vendimin e tij fillestar.

¹ Koncepti i llogaridhënies është pjesë e planit operacional të EULEX-it. Ai është dokument i kufizuar dhe nuk është i qashtëm për publikun. Prandaj Paneli nuk mund t'i zbulojë hollësitë që gjenden aty.

Rregullorja e Procedurës është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në faqen e internetit të Panelit, në <https://hrrp.eu/alb/reference-documents.php>.

1.6. Procedimi i rishikuar dhe i shpejtë i lëndëve

Me letrën e datës 18 shtator 2020, Paneli e informoi shefin e Misionit të EULEX-it se marrë parasysh pandeminë Covid-19 dhe masat e zbatuara për zbutjen e efekteve të saj, janë shkaktuar vonesa si në përpunimin e ankesave në pritje të Panelit, po ashtu edhe në komunikimet ndërmjet Panelit dhe ankuesve.

Prandaj, Paneli vendosi dhe e informoi Misionin që, me qëllim të përshpejtimit të procedimit të lëndëve të pazgjidhura, duke filluar nga fundi i vitit 2020, Paneli në përgjithësi do të merrej me çështjet e pranueshmërisë dhe meritave në të njëjtën kohë me një vendim të vetëm.

2. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave

2.1. Numri i lëndëve dhe statistikat

Që nga 1 janari 2022, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e pesë (25).

Paneli nuk ka pranuar ndonjë ankesë gjatë vitit 2022.

Paneli ka përfunduar dy (2) lëndë pasi ka përcjellë zbatimin e rekomandimeve të tij.


Paneli ka finalizuar dy (2) lëndë, duke e shpallur një lëndë të papranueshme dhe një lëndë tjetër e ka mbyllur pas përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të tij.


Paneli shpalli një (1) rast të pranueshëm dhe konstatoi se Misioni kishte shkelur të drejtat e njeriut të ankuesve në të njëjtin rast.

Vendimet vijuese janë miratuar në dy (2) raste, në një (1) prej të cilave Paneli ka vazhduar të vlerësojë zbatimin e rekomandimeve të tij.

Po ashtu, në një (1) rast të ri, kryesuesja e Panelit i ka dorëzuar shefit të Misionit një kërkesë për zbatimin e masave të përkohshme.

Numri i lëndëve në pritje më 31 dhjetor 2022 ishte njëzet e tre (23) lëndë.





Vini re se disa prej lëndëve kanë përmbajtur disa ankesa që jo të gjitha prej tyre kanë qenë të (pa)pranueshme.

2.2. Subjekti i ankesave

Ankesat që u shqyrtuan nga Paneli në vitin 2022 kryesisht kishin të bënin me raste të zhdukjeve me forcë, të cilat kishin ndodhur gjatë ose menjëherë pas konfliktit 1998-1999 në Kosovë. Ankesat kanë të bëjnë veçanërisht me shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetë nën pjesët e saj procedurale dhe të drejtën për mos iu nënshtroar torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues si rezultat i vuajtjeve të shkaktuara nga zhdukja dhe mungesës së një hetimi efektiv, siç garantohet nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane. Paneli vendosi për rastin e fundit të tilla që ishte në pritje para tij dhe vazhdoi të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të tij nga shefi i Misionit.

Një nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2022 kishte të bënte me kushtet e paraburgimit të një të burgosuri me sëmundje të rëndë dhe ndikimin e trajtimit të tij tek familjarët e tij. Paneli konstatoi se ankesat ishin jashtë fushëveprimit të juridiksionit të tij.

Një ankesë e marrë në vitin 2021 kishte të bënte me një dëshmitar të mbrojtur dhe ndikimin e statusit të tij tek ai dhe familja e tij. Në vitin 2022, për të garantuar sigurinë e ankuesit dhe të familjes së tij, kryesuesja e Panelit i kërkoi shefit të Misionit që të zbatoj masa të përkohshme në pritje të shqyrtimit të rastit.

2.3. Seancat e Panelit

Gjatë vitit 2022, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur dy (2) seanca. Të dyja seancat u mbajtën në zyrë në Prishtinë, edhe pse një ditë shtesë e seancës së dytë u mbajt me mjete elektronike, siç autorizohet nga rregullën 13, shqyrtimet, paragrafi 3 i Rregullores së punës.

- Sesioni i 53-të: 22-25 mars 2022;
- Sesioni i 54-të: 5-7 korrik dhe 18 gusht 2022.

3. Jurisprudenca

3.1. Hyrje

Paneli vazhdoi me zhvillimin e jurisprudencës së vet dhe nxori një numër vendimesh rreth meritave dhe pranueshmërinë gjatë periudhës raportuese.

Duke vepruar kështu, Paneli u mbështet gjerësisht në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNj), jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), por gjithashtu nxori mësim nga instrumente të tjera, si dhe vendime dhe deklarata të organeve monitoruese përkatëse. Kjo përfshinë konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe mekanizma monitorues përkatës, Konventa Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (dhe çështja e lidhur me të), si dhe jurisprudencën e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, jurisprudencën e vet, si dhe ligjin në fuqi në Kosovë.

Përveç kësaj, Paneli nxori dy (2) vendime për vazhdimin e vendimeve të mëparshme për meritat dhe vazhdoi të monitorojë zbatimin e rekomandimeve nga Misioni të lëshuara nga Paneli. Aftësia e Panelit për të përcjellë rekomandimet e tij është një element i rëndësishëm i infrastrukturës së tij normative për aq sa i lejon që të sigurojë që rekomandimet e tij janë marrë në konsideratë siç duhet dhe plotësisht nga Misioni dhe se ato janë zbatuar në masën më të madhe të mundshme.

Në fillim, kryesuesja e Panelit vendosi edhe për kërkesën për marrjen e masave të përkohshme.

3.2. Vendimet për meritat

Paneli ka marrë një (1) vendim rreth meritave gjatë vitit 2022.

Seanca e panelit e datës 18 gusht 2022

- [Lënda 2016-29 Slađana Savić kundër EULEX-it](#). Më 18 gusht 2022, Paneli miratoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat. Në vendimin e tij, Paneli përcaktoi se EULEX-i kishte dështuar në kryerjen e një hetimi efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankueses dhe nuk e kishte mbajtur të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli përcaktoi se Misioni ishte përgjegjës për shkelje sipas pjesës procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, siç garantohet me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkelje të së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'iu pyesë autoritetet se çfarë hapash janë duke u ndërmarrë për të hetuar këtë rast, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe për t'iu informuar për rrjedhën e përgjithshme të hetimit. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesen me qëllim të gjetjes së një mjeti juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi i këtyre rekomandimeve nga Misioni është në pritje.

3.3. Vendimet e pranueshmërisë

Paneli ka marrë dy (2) vendime për (pa)pranueshmëri në vitin 2022.

Seanca e panelit e datës 7 korrik 2022

Paneli në këtë seancë ka marrë një (1) vendim për papranueshmëri.

- [Lënda 2019-02 Driton Hajdari dhe Teuta Bici-Hajdari kundër EULEX-it](#). Më 7 korrik 2022, Paneli e shpalli këtë rast të papranueshëm. Ankesa lidhej me kushtet e paraburgimit të ankuesit të parë dhe ndikimin që rezultoi tek ankuesi i dytë. Paneli e shpalli këtë ankesë të papranueshme për shkak se ngjarjet për të cilat u ankua nuk i atribuoheshin EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv, dhe për këtë arsye nuk hynin në fushëveprimin e juridiksionit të Panelit.

Seanca e panelit e datës 18 gusht 2022

Paneli në këtë seancë ka marrë një (1) vendim për pranueshmëri.

- [Lënda 2016-29 Slađana Savić kundër EULEX-it](#). (Shih më lart nën Vendimet mbi meritat).

3.4. Vendimet rreth kërkesave për rishqyrtim

Paneli nuk ka marrë asnjë kërkesë për rishqyrtim gjatë vitit 2022.

3.5. Vendimet për Kërkesat për Marrjen e Masave të Përkohshme

- [Lënda 2021-02 O.L. dhe të tjerët kundër EULEX-it](#). Më 24 gusht 2022, kryesuesja e Panelit nxori një vendim mbi kërkesën për miratimin e masave të përkohshme, në autoritetin e saj sipas rregullës 22 Masat e përkohshme të Rregullores së Punës së Panelit. Shefit të Misionit iu kërkua të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm, në përpjesëtim me rrezikun për jetën e ankuesit ose familjes së tij, dhe brenda mandatit të tij, për të garantuar sigurinë e ankuesve. Kryesuesja e ftoj shefin e Misionit t'i raportojë Panelit për veprimet e ndërmarra.

3.6. Vendimet pasuese

Paneli ka nxjerrë dy (2) vendime pasuese gjatë vitit 2022.

Seanca e panelit e datës 6 korrik 2022

- [Lënda 2018-01 Y.B.2 kundër EULEX-it](#). Me vendimin e datës 16 shtator 2021, Paneli përcaktoi se EULEX-i ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesit për respektimin e jetës së tij private, siç mbrohen me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më 6 korrik 2022, Paneli miratoi Vendimin e tij për Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit. Në vendimin e tij, Paneli theksoi se shefi i Misionit të EULEX-it kishte refuzuar të lëshonte një deklaratë publike për të pranuar shkeljen e të drejtave të ankuesit. Paneli shprehu keqardhje për mos zbatimin e rekomandimit të Panelit, por vendosi se nuk do të ishte e dobishme të përsëritej rekomandimi i tij. Paneli vendosi të mbyllë shqyrtimin e lëndës.

Seanca e panelit e datës 18 gusht 2022

- [Lënda 2011-20 X. dhe 115 të tjerë kundër EULEX-it](#). Me vendimin e datës 22 prill 2015, Paneli përcaktoi se EULEX-i ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesve për mjet efektiv, siç garantohet me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit. Më 11 nëntor 2015, më 10 janar 2017, më 27 mars 2019 dhe përsëri më 11 dhjetor 2019, Paneli ka përcjellë zbatimin e rekomandimeve të tij.

Më 18 gusht 2022, Paneli miratoi Vendimin e pestë për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Në vendimin e tij, Paneli theksoi se ankuesve ende duhet që t'u sigurohet ndonjë mjet dhe kompensim adekuat për shkeljen e të drejtave të tyre. Paneli përsëriti ftesën e tij drejtuar EULEX-it që të kryejë një rishikim të plotë të mjeteve në dispozicion të Misionit për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të ankuesve në mënyrë efektive dhe për t'i raportuar Panelit për masat që ai propozon t'i ndërmer për ta bërë këtë. Paneli gjithashtu ftoi Misionin që të shqyrtojë qasjen ndaj shteteve anëtare përmes Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm në lidhje me mundësinë e dëmshpërblimit ose kompensimit për shkeljen e të drejtave të ankuesve që i atribuohen Misionit prej Panelit.

4. Aktivitetet e tjera të Panelit

4.1. Takimet

Më 5 korrik 2022, Paneli u takua me z. Lars-Gunnar Wigemark, shëf i Misionit të EULEX-it Kosovë. Diskutimi u përqendrua rreth rekrutimit të anëtarëve të rinj të Panelit dhe zbatimit të rekomandimeve të Panelit në njëzet (20) rastet e personave të zhdukur.

4.2. Fushata informuese

Koncept Dokumenti i Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009 theksoi, ndër të tjera, në paragrafin E, se, "...EULEX-i Kosovë do të sigurojë një shpërndarje të duhur të informacionit publik për Panelin dhe punën e tij..."

Komandanti i Operacioneve Civile, në udhëzimin e tij të datës 13 nëntor 2009, deklaroi, në lidhje me Panelin, se Udhërrëfyesi për Aftësinë e Sjelljes së Planifikimit Civil duhet të përfshijë, "*... përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse informuese*".

4.2.1. Takimet me organizatat kosovare

Gjatë vitit 2022, Paneli dhe Sekretariati nuk kanë mbajtur ndonjë takim me organizata kosovare.

4.3. Trajnimi hyrës

Pjesëtarët e sapoardhur të Misionit kanë marrë një trajnim hyrës që përfshin një komponent në lidhje me mandatin dhe funksionimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Sekretariati ka ofruar materiale bazike në mbështetje të këtij trajnimi. Ky proces është i dobishëm për t'i njoftuar anëtarët e ardhshëm të stafit rreth mandatit të Panelit, për të nënvizuar më tej rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për EULEX-in Kosovë dhe që anëtarët e stafit të EULEX-it të kenë njohuri më shumë për Panelin në fushën e operacioneve të EULEX-it Kosovë. Ky është një element i rëndësishëm në procesin që të sigurohet se stafi i Misionit të ndërgjegjësohet rreth detyrimeve të veta ndaj të drejtave të njeriut dhe të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me të.

4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së

Sekretariati e mirëmban faqen e internetit të Panelit: <https://hrrp.eu/alb/>. Kjo faqe përmban informata lidhur me mandatin, procedurat dhe punën e Panelit, si dhe informata të përditësuara rregullisht lidhur me vendimet e Panelit, si dhe listën e lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe ato të përfunduara. Aty ofrohet qasje e lehtë në tabelën e jurisprudencës së Panelit. Aty paraqitet praktika gjyqësore në rritje e sipër e Panelit sipas çështjes së lëndëve, si në bazë të pranueshmërisë dhe përmbajtjes së rasteve që janë në shqyrtim. Ajo është krijuar, mes tjerash, për të siguruar qasje të gatshme dhe të lehtë në praktikën gjyqësore të Panelit për ankuesit, juristët dhe për opinionin e gjerë: (<https://hrrp.eu/alb/jurisprudence.php>).

Paneli gjithashtu ka ofruar disa "Shënime të jurisprudencë" që përmbledhin sipas temave disa nga aspektet më të rëndësishme të jurisprudencës së tij (http://hrrp.eu/Case-Law_Notes.php).

Përveç kësaj, Paneli ka publikuar tri (3) video informative në ueb faqen e tij në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Këto mbulojnë temat e mëposhtme:

- a. Hyrje në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut;
- b. Si mund të bëni një ankesë në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut?; dhe
- c. Çfarë bën Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut me ankesën tuaj?

Këto video publikohen në faqen e internetit të Panelit dhe faqen në Facebook dhe në LinkedIn.

Të tria videot informuese mund të gjenden në: <https://hrrp.eu/alb/videos.php>

Faqja e internetit e PShDNj-së ofron gjithashtu informacione për:

Standardet e aplikueshme për të drejtat e njeriut: (<https://www.hrrp.eu/alb/relevant-rights.php>);

Formularët e aplikimit dhe udhëzimet për paraqitjen e ankesës: (<https://hrrp.eu/alb/Questions%20and%20answers.php>);

Për më tepër, Paneli ka profil në Facebook dhe LinkedIn: Human Rights Review Panel. Informacioni i mësipërm është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

5. Paneli dhe Sekretariati

5.1. Anëtarët e Panelit

Sipas Konceptit të Llogaridhënies dhe Rregullores së Punës së Panelit, Paneli përbëhet prej katër anëtarëve; dy anëtarë të jashtëm dhe dy anëtarë të EULEX-it, prej të cilëve njëri është zëvendës i tjetrit. Para rishikimit të mandatit në qershor të vitit 2018, të dy anëtarët e EULEX-it ishin anëtarë të personelit të EULEX-it të emëruar për të punuar si gjykatës në sistemin gjyqësor të Kosovës. Pas rishikimit të mandatit, dy anëtarët e EULEX-it janë anëtarë të personelit të Shtyllës së Monitorimit të EULEX-it.

Përbërja e Panelit ndryshoi ndjeshëm gjatë vitit 2022. Përkundër disa proceseve të jashtme të rekrutimit, pozita e lirë e njërit prej anëtarëve të jashtëm të Panelit nuk ka mundur të plotësohet gjatë vitit 2022. Në gusht 2022, anëtari i Panelit të EULEX-it z. Alexander Fassihi dha dorëheqjen. Nuk ishte e mundur të rekrutohej një anëtar zëvendësues i EULEX-it gjatë vitit 2022.

5.1.1. Kryesuesja e Panelit

Pas emërimit të saj në Panel, znj. Snježana Bokulić u bë ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit.

5.1.2. Anëtarët deri më 31 dhjetor 2022

Znj. Snježana Bokulić – Anëtare e Jashtme, ushtruese e detyrës së kryesueses, e emëruar më 6 dhjetor 2021.

Snježana Bokulić është avokate e të drejtave të njeriut, e cila ka punuar në organizata ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare për më shumë se dy dekada duke zbatuar ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut për të avancuar respektimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve në pesë kontinente. Është e specializuar në të drejtat e pakicave, të drejtat e popujve indigjenë, mos diskriminimin dhe ndërsektorialitetin. Ajo ka punuar gjerësisht në llogaridhënien e organizatave dhe krijimin e mekanizmave të ankesave të organizatave.

Si shefe e departamentit të të drejtave të njeriut të OSBE/ODIHR-it, znj. Bokulić ka drejtuar misione të vlerësimit të të drejtave të njeriut të ODIHR-it në Ukrainë dhe në Bazën Detare të Guantanamo, si dhe misionin e monitorimit të gjyqimit në Bjellorusi. Ajo ka udhëhequr programin e monitorimit të lirisë së tubimeve paqësore të ODIHR-it dhe ka udhëhequr hartimin e udhëzimeve të ODIHR-it për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Ajo është kryetare e Panelit të Pavarur për Shqyrtim në Accountable Now, një platformë globale e anëtarësimit që synon të rrisë llogaridhënien në organizata të shoqërisë civile, dhe është anëtare e Këshillit të the3million, organizatës më të madhe me bazë në komunitet të qytetarëve të BE-së në Mbretërinë e Bashkuar.

Znj. Bokulić mban titullin e masterit në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga Universiteti i Essex-it, po ashtu mban titullin e masterit në studimet e Evropës Juglindore nga Universiteti i Evropës Qendrore dhe diplomë të studimeve themelore nga Kolegji Notre Dame në Maryland.

Shefi i Misionit të EULEX-it ka emëruar znj. Bokulić anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 6 dhjetor.

Z. Petko Petkov – Anëtar zëvendësues i EULEX-it, i emëruar më 19 dhjetor 2018.

Z. Petko Petkov ka diplomuar në Universitetin e Sofjes me titullin magjistër i juridikut. Ai ka shërbyer gjykatës i ri në Gjykatën e Rrethit të Sofjes nga viti 2005 deri në vitin 2007 dhe që nga viti 2007 është gjykatës në Divizionin Penal në Gjykatën Rajonale të Sofjes. Gjatë karrierës së tij si gjykatës penal ka punuar në mijëra raste dhe thelbi i punës së tij ka qenë që t'iu përmbahet gjithmonë parimeve të KEDNj-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga viti 2014 deri në vitin 2015 ai u emërua ekspert për zëvendësministrin e Drejtësisë të Republikës së Bullgarisë. Gjatë kësaj periudhe ai ishte përgjegjës për përfaqësimin e vendit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe duhej të ofronte udhëzime metodologjike dhe kontroll mbi veprimtarinë e Drejtorisë brenda Ministrisë. Përveç detyrave që kanë të bëjnë me përcaktimin e mënyrës së veprimit të përfaqësimit procedural para GjEDNj-së, ai ishte i përfshirë drejtpërdrejt në hartimin e ndryshimeve legislative në lidhje me gjyqësorin.

Prej vitit 2012 deri në vitin 2015 ka qenë ligjërues mysafir rreth të Drejtës Penale në Institutin Kombëtar të Trajnimit për Gjyqësorin, ku ka zgjeruar dhe zhvilluar njohuritë e tij në një nivel më teorik dhe akademik.

Ai iu bashkua EULEX-it Kosovë në vitin 2017 si gjyqtar penal ndërkombëtar, ku ka punuar deri në fund të mandatit ekzekutiv të Misionit në vitin 2018. Aktualisht është vëzhgues tematik në fushën e krimeve sipas ligjit ndërkombëtar në EULEX.

Z. Petkov është emëruar anëtar zëvendësues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefja e Misionit të EULEX-it Kosovë më 19 dhjetor 2018.

5.2. Sekretariati

Sekretariati i Panelit përbëhet nga një zyrtar ligjor dhe dy përkthyes/interpret. Sekretariati ndodhet në ambiente të dedikuara ku gjenden administrata, regjistrat dhe arkivat e tij, jashtë vendndodhjes së EULEX-it Kosovë.

Sekretariati ofron mbështetje ligjore dhe administrative, si dhe shërbime gjuhësore për Panelin. Sekretariati pranon gjithashtu ankesa (potenciale) dhe siguron komunikimet dhe korrespondencat midis Panelit dhe ankuesve, dhe përkatësisht shefit të Misionit. Sekretariati mundëson po ashtu kontaktet me të gjitha komunitetet e Kosovës.

6. Çështjet operative dhe administrative

6.1. Buxheti

Paneli nuk ka në dispozicion buxhet të pavarur, edhe pse kërkesat e tij modeste për shpenzime miratohen nga Misioni aty për aty.. Në vitin 2022, Paneli nuk ka parashtruar asnjë kërkesë për shpenzime.

6.2. Burimet njerëzore

Stafi i Sekretariatit të Panelit ka mbetur i njëjtë përgjatë vitit 2021.

7. Konkluzionet dhe rekomandimet

7.1 Konsideratat e përgjithshme

Gjatë vitit 2022, ka pasur dy çështje të përgjithshme që kanë ndikuar në aftësinë e Panelit për të kryer punën e tij. Së pari, ekziston një ritëm i ngadalshëm i reagimit nga ana e Misionit ndaj komunikimeve të Panelit. Së dyti, ka pasur probleme të vazhdueshme me plotësimin e vende të lira të punës në Panel.

Siç është cekur në këtë raport vjetor, Paneli ka qenë i zhgënjyer me mungesën e përgjigjes së duhur ndaj rekomandimeve të Panelit pas konstatimit të shkeljes nga Misioni. Në veçanti, në të gjitha lëndët në pritje të vendimeve pasuese në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit, Misioni ose nuk ka pasur përgjigje ndaj kërkesave që ai të raportojë, ose përgjigjet e Misionit kanë qenë jashtëzakonisht të kufizuara. Në njëzet (20) lëndët e zhdukjeve të dhunshme, premtimi i shefit të Misionit për të vizituar secilën nga familjet e prekura individualisht, deri më tani ka rezultuar në vetëm katër (4) vizita te familjeve.

Përveç kësaj, në një rast të sapo komunikuar, parashtrësat e Misionit në përgjigje të pyetjeve të Panelit nuk janë dorëzuar brenda afateve të kërkuara.

